



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije  
Ministry of Trade and Industry



AGJENCIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA  
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

**RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR  
REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE NË KOSOVË PËR  
PERIUDHËN:  
KORRIK-SHTATOR 2020**

**AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS**

**TETOR 2020**

## **PËRMBAJTJA**

<b>I. HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>II. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHOQËRIVE TREGTARE .....</b>	<b>4</b>
<b>III. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHPK-VE .....</b>	<b>5</b>
<b>IV. KOHËZGJATJA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRAVE TË REGJISTRIMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>V. REGJISTRIMI DHE Ç'REGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE.....</b>	<b>7</b>
<b>VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË SHOQËRIVE TË HUAJA TREGTARE SIPAS SHTETIT TË ORIGJINËS .....</b>	<b>7</b>
<b>VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ .....</b>	<b>8</b>
<b>VIII.REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË .....</b>	<b>9</b>
<b>IX. PËRMBLEDHJE NGA ARBK PËR TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2020 (T3 KORRIK-SHTATOR 2020) .....</b>	<b>10</b>
<b>X. PËRMBLEDHJE NGA ARBK VITI 2000 – SHTATOR 2020 .....</b>	<b>11</b>

## I. HYRJJE

Ky raport paraqet rezultatet e indikatorëve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë për tremujorin e tretë të vitit 2020, punuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “ARBK”)

Ky raport i indikatorve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit është punuar gjatë kohës së Pandemisë Covid-19 dhe krahas pandemisë Arbk qëndron në nivel shumë të kënaqshëm sa i përket kohës së regjistrimit dhe numrit të bizneseve.

Gjatë kësaj periudhe, një ekip i përbërë nga zyrtarët e ARBK-së nga fusha e Teknologjis Informative kanë analizuar një sërë indikatorësh të lidhur me performancën e ARBK-së:

- Kohëzgjatjen për regjistrimin e shoqërive tregtare në përgjithësi në Kosovë dhe për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në veçanti, si dhe sipas qendrave të regjistrimit;
- Numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe numrin total të shoqërive tregtare të ç’rejistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare;
- Numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara sipas shtetit të origjinës;
- Numrin e pronarëve, ortakëve ose aksionarëve të huaj të përfshirë në shoqëritë tregtare të Kosovës sipas llojit të shoqërive tregtare;
- Përqindjen e bizneseve individuale sipas gjinisë; dhe
- Përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë në shoqëritë tregtare në Kosovë.

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i ARBK-së për shoqëritë tregtare që sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare<sup>1</sup> në Kosovë kërkohen të regjistrohen në ARBK. Sipas këtij ligji, ARBK regjistron pesë forma themelore të shoqërive tregtare: (1) Bizneset Individuale, (2) Ortakëritë e Përgjithshme, (3) Ortakëritë e Kufizuara, (4) Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara dhe (5) Shoqëritë Aksionare. Përveç këtyre formave themelore në ARBK regjistrohen edhe (1) Degët e Shoqërive të Huaja Tregtare, (2) Zyrat e Përfaqësisë të Shoqërive të Huaja Tregtare, (3) Ndërmarrjet Publike sipas ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, (4) Ndërmarrjet Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe (5) Çfarëdo subjekti tjetër që me ligj të veçantë kërkohet të regjistrohet në ARBK si p.sh. Kooperativat Bujqësore.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (T3 2019), në këtë tremujor (T3 Korrik-Shtator 2020) vërehet një rënie e kohëzgjatjes së regjistrimit për të gjitha shoqëritë tregtare prej 1%<sup>2</sup>.

**Kufizimet e raportit:** Për qëllime të këtij raporti, **kohëzgjatja** është llogaritur duke pas parasysh vetëm ditët e punës prej datës së aplikimit deri në aprovimin e aplikacionit për regjistrim. Ky raport nuk bën ndonjë supozim dhe nuk ofron shifra lidhur me shoqëritë tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, mirëpo fokusohet kryesisht në matjen e efikasitetit të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit në zhvillimin e procedurave të regjistrimit ose ç’regjistrimit të shoqërive tregtare. Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë, dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë, ekziston nevoja për një përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të dytë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.


<sup>1</sup> Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>

<sup>2</sup> Formula:  $(Vlera\ e\ re\ (V2) - Vlera\ e\ vjetër\ (V1)) \div Vlera\ e\ vjetër\ (V1) \times 100\% = Ndryshimi\ në\ përqindje$

## II. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHOQËRIVE TREGTARE

Shoqëritë tregtare, siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kërkohen të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare nëpër Kosovë. Kjo pjesë e raportit paraqet kohëzgjatjen e regjistrimit të shoqërive tregtare duke llogaritur vlerën mesatare të diferencës së ditëve të punës që nga data aplikimit deri tek data e aprovimit. Kohëzgjatja e regjistrimit për të gjitha shoqëritë tregtare gjatë tremujorshit të tretë të vitit 2020 (T3 Korrik-Shtator 2020) ishte **2.59 ditë**, ku vërehet një përmirësim prej **1%** krahasuar me 2.62 ditë sa ishte në tremujorëshin e njëjtë të vitit të kaluar (T3 Korrik-Shtator 2019).


**Grafiku I:** Kohëzgjatja mesatare për regjistrimin e të gjitha formave të shoqërive tregtare, Korrik-Shtator 2020 (T3 2020) dhe krahasimi me Korrik-Shtator 2019 (T3 2019):



### III. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHPK-VE


Kjo pjesë e raportit paraqet vetëm kohëzgjatjen e regjistrimit të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Kohëzgjatja mesatare e regjistrimit vetëm e SHPK-ve në të gjitha qendrat e regjistrimit përfshirë edhe qendrën kryesore në Prishtinë (**Grafiku 2**) gjatë tremujorshit të tretë të vitit 2020 (T3 Korrik-Shtator 2020) ishte **3.12**, ku vërehet një përmirësim prej **6%** krahasuar me 3.31 ditë sa ishte në tremujorëshin e njëjtë të vitit të kaluar (T3 Korrik-Shtator 2019).

**Grafiku 2:** Kohëzgjatja mesatare vetëm për regjistrimin e SHPK-ve, Korrik-Shtator 2020 (T3 2020) dhe krahasimi me Korrik-Shtator 2019 (T3 2019):



Për më tepër, **Grafiku 3** tregon kohëzgjatjen për regjistrimin e SHPK-ve vetëm në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë. Kohëzgjatja mesatare e regjistrimit vetëm e SHPK-ve në Prishtinë (**Grafiku 3**) gjatë tremujorshit të tretë të vitit 2020 (T3 Korrik-Shtator 2020) ishte **2.94 ditë**, ku vërehet një përmirësim prej **22%** krahasuar me 3.75 ditë sa ishte në tremujorëshin e njëjtë të vitit të kaluar (T3 Korrik-Shtator 2019).

**Grafiku 3:** Kohëzgjatja mesatare për regjistrimin e SHPK-ve vetëm në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë, Korrik-Shtator 2020 (T3 2020) dhe krahasimi me Korrik-Shtator 2019 (T3 2019):



## IV. KOHËZGJATJA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRAVE TË REGJISTRIMIT

**Tabela I** tregon kohëzgjatjen mesatare për regjistrimin e të gjitha formave të shoqërive tregtare të ndara në 29 qendrat komunale për regjistrim si dhe në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë. Ndarja sipas qendrave të regjistrimit në tabelën më poshtë është bazuar në supozimin se nëse një shoqëri tregtare e ka adresën e regjistrimit p.sh në qytetin e Gjilanit, atëherë e njëjta po ashtu edhe është regjistruar në qendrën e regjistrimit në Gjilan, edhe pse ekziston mundësia që ajo shoqëri tregtare të jetë regjistruar në qendrën kryesore të ARBK-së në Prishtinë. Kjo është për arsye se ARBK aktualisht ka një sistem unik të regjistrimit të shoqërive tregtare i cili përfshin të dhënat për shoqëritë tregtare të regjistruara në të gjithë territorin e Kosovës, por jo sipas qendrave të regjistrimit.

**Tabela I:** Kohëzgjatja për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas Qendrave për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare, Korrik-Shtator 2020:

Qendra e Regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Mesatarja	Nr. i shoqërive tregtare
Deçan	1.60	2.43	3.75	2.32	28
Dragash	6.50	2.00	3.40	3.79	14
Ferizaj	3.12	3.73	3.11	3.30	186
Fushë Kosovë	2.32	3.42	3.87	3.20	91
Gjakovë	1.41	2.30	1.65	1.88	114
Gjilan	3.50	3.05	3.13	3.23	138
Glllogoc	2.18	1.24	2.79	2.04	53
Graçanicë	4.40	3.33	2.73	3.27	22
Hani i Elezit	2.33	2.00	2.00	2.20	5
Istog	3.36	1.93	1.87	2.37	43
Kaçanik	4.09	4.00	4.00	4.03	36
Kamenicë	1.65	1.24	1.83	1.50	40
Klinë	2.63	2.94	2.92	2.86	37
Lipjan	3.20	2.27	2.87	2.78	73
Malishevë	1.47	1.35	1.71	1.50	48
Mitrovicë	2.32	1.65	2.32	2.03	100
Mitrovicë Veriore	2.00	2.00	2.50	2.22	23
Novobërdë	7.67	1.50		4.14	7
Obiliq	3.00	2.00	1.57	1.95	44
Pejë	1.58	1.54	1.90	1.67	141
Podujevë	1.27	1.52	1.94	1.59	91
Prishtinë	2.97	2.88	2.78	2.88	771
Prizren	3.19	1.84	2.42	2.48	208
Rahovec	2.33	3.00	3.00	2.83	24
Shtërpcë	2.50	2.00	3.00	2.60	5
Shtime	2.22	1.67	1.58	1.79	33
Skenderaj	1.90	2.08	3.56	2.32	41
Suharekë	2.00	2.21	2.20	2.12	49
Viti	1.76	3.88	2.70	2.56	48
Vushtrri	2.19	3.43	2.55	2.79	80
<b>Mesatarja</b>	<b>2.61</b>	<b>2.52</b>	<b>2.65</b>	<b>2.59</b>	<b>2593</b>

\*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të madhe të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

\*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të vogël të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

## V. REGJISTRIMI DHE Ç'REGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE

**Tabela 2** më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara si dhe numrin e shoqërive tregtare të ç'regjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare të definuara me ligj për muaj, nga muaji Korrik deri në Shtator të vitit 2020. Forma ligjore me numrin më të madh të regjistrimeve gjatë këtij tremujorëshi ka qenë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, pasuar nga Biznesi Individual. Forma ligjore me numrin më të madh të shuarjeve për këtë periudhë ishte Biznesi Individual, pasuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

**Tabela 2:** Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe ç'regjistruara sipas formës ligjore, Korrik-Shtator 2020:

SHOQËRI TREGTARE	Muaji											Totali
		(1) Biznes Individual	(2) Ortakëri e Përgjithshme	(3) Ortakëri e Kufizuara,	(4) Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	(5) Shoqëri Aksionare	(1) Degë e Shoqërive të Huaja Tregtare	(2) Zyrë e Përfaqësisë të Shoqërive të Huaja Tregtare	(3) Ndërmarrjet Publike	(4) Ndërmarrjet Shoqërore	(5) Kooperativa Bujqësore	
TË REGJISTRUARA	Korrik	354	1		487	1	5					848
	Gusht	381			458	2	4					845
	Shtator	349			546	1	4					900
	<b>Totali</b>	<b>1,084</b>	<b>1</b>		<b>1,491</b>	<b>4</b>	<b>13</b>					<b>2,593</b>
TË Ç'REGJISTRUARA	Korrik	89	1		7							97
	Gusht	115			10		2					127
	Shtator	115			6							121
	<b>Totali</b>	<b>319</b>	<b>1</b>		<b>23</b>		<b>2</b>					<b>345</b>

## VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË SHOQËRIVE TË HUAJA TREGTARE SIPAS SHTETIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në ARBK dhe Qendrat Komunale të Regjistrimit bëhet regjistrimi edhe i degëve të shoqërive të huaja tregtare. **Tabela 3** më poshtë tregon numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për periudhën Korrik-Shtator 2020.

**Tabela 3:** Degët e shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë sipas shtetit të origjinës, Korrik-Shtator 2020:

Shteti i origjinës	Numri i degëve të shoqërive të huaja tregtare
Angli	3
Bosnja dhe Hercegovina	1
Çekia	1
Shqipëria	5
Romania	1
Turqi	1
Zvicër	1
<b>Totali</b>	<b>13</b>

## VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ

Për ta vlerësuar pjesëmarrjen e personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë në shoqëri tregtare në Kosovë janë paraqitur të dhënat në **Tabelën 4**, të cilat tregojnë numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, mirëpo kjo nuk tregon kapitalin e investuar nga personat e huaj. Gjatë periudhës Korrik-Shtator 2020 janë regjistruar gjithsej 2,593 shoqëri tregtare nga të cilat 136 kanë të paktën një person të huaj fizik ose juridik si pronar, ortak ose aksionar, ku shihet se shumica janë SHPK-kë pasuar nga bizneset individuale. Nga kjo tabelë janë përjashtuar degët e shoqërive të huaja tregtare pasi që ato janë të paraqitura më lartë në **Tabelën 3**.

**Tabela 4:** Numri i të gjitha shoqërive tregtare (përjashtuar degëve) në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, Korrik-Shtator 2020 (T3 2020):


SHOQËRI TREGTARE	Muaji											Totali
		(1) Biznes Individual	(2) Ortakëri e Përgjithshme	(3) Ortakëri e Kufizuara,	(4) Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	(5) Shoqëri Aksionare	(6) Degë e Shoqërive të Huaja Tregtare	(7) Zyrë e Përfaqësimit të Shoqërive të Huaja Tregtare	(8) Ndërmarrjet Publike	(9) Ndërmarrjet Shoqërore	(10) Kooperativa Bujqësore	
TË REGJISTRUARA	Korrik	4	0	0	43	0	0	0	0	0	0	47
	Gusht	4	0	0	39	1	0	0	0	0	0	44
	Shtator	6	0	0	39	0	0	0	0	0	0	45
	<b>Totali</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>121</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>136</b>




## VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË

Të dhënat në **Grafikun 4 dhe 5** paraqesin pjesëmarrje sipas gjinisë në shoqëritë tregtare të regjistruara gjatë periudhës Korrik-Shtator 2020. Për shkak të natyrës së formave të ndryshme ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat më poshtë paraqiten ndaras për Bizneset Individuale, të cilat kanë pronar të vetëm dhe janë zakonisht biznese të vogla, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku pronarët marrin pjesë si ortakë apo aksionarë në shoqëri tregtare më të mëdha ose më diverse.


Grafiku 4: Përqindja e Bizneseve Individuale sipas Gjinisë, Korrik-Shtator 2020 (T3 2020):




Grafiku 5: Përqindja e Ortakëve dhe Aksionarëve sipas Gjinisë, Korrik-Shtator 2020 (T3 2020):



## IX. PËRMBLEDHJE NGA ARBK PËR TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2020 (T3 KORRIK-SHTATOR 2020)



### Kohëzgjatja



## X. PËRMBLEDHJE NGA ARBK VITI 2000 – SHTATOR 2020

**205,672**

Shoqëri Tregtare  
të **regjistruara**



**29,098**

Shoqëri Tregtare  
të **ç'regjistruara**

